



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 06 -2009
Prishtinë, më 02. mars 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj Bajram Kosumi, Kolë Berisha Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Džezair Murati dhe Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: Lejla Selimi - OSBE, Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti dhe Reshit Gashi - NDI, Blerta Ukmata – EULEX, Valeri Brasey – EULEX, Lumnije Murati - ZPRK dhe Nathalia Berkonitz – EULEX.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23 shkurtit 2009;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit, si: NDI-në, OSBE-në, EULEX-in, ata të Zyrës së Presidentit, mjetet e informimit etj. dhe i njoftoi për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23 shkurtit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore

Kryetari – E dini se Projektligji për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore ka qenë në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, por është kthyer nga Komisioni për të metat dhe mangësitë që i ka pasur. Tash para Komisionit kemi një draft të mirë. Mendoj se i plotëson kriteret, sepse është punuar në bashkëpunim edhe me ekspertët e EULEX-it. Në ato takime kam marrë pjesë edhe unë. Tash e kemi edhe raportin preleminar të Zyrës për Standardizim, Harmonizim dhe Përafrim me Legjislacionin e BE-së, që nuk ka vërejtje serioze, përpos atyre gjuhësore që do të përmirësohen në lekturim. Në vazhdim shtoi se dispozitat e fundit të këtij projektligji janë të Eulex-it. Me siguri do të ketë diskutime edhe në seancë nga deputetët. Këtë projektligj po e shqyrtojmë në parim. I pyeti të pranishmit a kanë vërejtje lidhur me këtë projektligj.

Ibrahim Makolli – Duke u ndërlidhur me parafolësin pyeti pse tash duhet të kemi bashkëkryesues ndërkombëtar (neni 7 i këtij projektligji), sepse në këtë kohë nuk duhet të ketë bashkëkryesues.

Armend Zemaj – Në diskutimin e tij pati dilema për kompetencat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Mjekësisë Ligjore (në nenin 6 të Projektligjit). Pyeti se mos këto dispozita bien ndesh me forenzikën.

Adem Salihaj – Në diskutimin e tij shtoi se duhet të punojmë në bazë të Kushtetutës. Gjithashtu edhe EULEX-i duhet të punojë në bazë të Kushtetutës. Shtrohet pyetja a duhet të ketë EULEX-i edhe tash bashkëkryesues?

Adem Hajdaraj – Tha se termi bashkëkryesues mund të zëvendësohet me këshilltar.

Kryetari – Arsyeja pse kërkojnë të kenë bashkëkryesues është se një pjesë të gjykimëve do t'i kryejë edhe EULEX-i. Ta miratojmë në parim këtë projektligj, pastaj

në Komision mund ta amendamentojmë, sepse do të ketë edhe diskutime në Kuvend. I pyeti të pranishmit a pajtohen të miratohet në parim ky projektligj.

Komisioni, me disa vërejtje, e miratoi në parim Projektligjin për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës u diskutua si të procedohet më tutje Ligji për të drejtat sendore, që është kthyer në Kuvend dhe që ka një numër bukur të madh të amendamenteve.

Kryetari - Tha se kemi menduar që amendamentet të bëhen kapitull për kapitull, p.sh 20 nene vetëm në një nen. Kjo ka mundësi të bëhet në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit, në nenin 37.

Ramadan Gashi - Theksoi se teksti i këtij projektligji duhet të shikohet edhe një herë, sepse ka disa lëshime. Po të procedohet në këtë mënyrë do të ishte shumë mirë.

Haxhi Gashi - ekspert i NDI-së - Tha se më mirë do të ishte që Projektligji të procedohet i shkruar në dy shtylla - në njërën teksti i vjetër dhe në tjetrën teksti i ri.

Kryetari - Ishte i mendimit se ky projektligj duhet të kalojë edhe një herë në Komision, me qëllim të diskutimit përfundimtar. Propozoi që në kuadër të nënkomisionit për hartimin e Projektligjit për rregullimin dhe funksionimin e Komisionit Hetimor të përfshihen edhe Ibrahim Makolli dhe Branisllav Grbiq. Tha se duhet të mblidhemi më 04. 03. 2009, në orën 13, me qëllim që ta hartojmë Projektligjin. Për diskutim e shtroi edhe çështjen e kërkesës së 125 magjistrave të mjekësisë dhe të 80 doktorantëve legalë të shkencave mjekësore, që iu kanë drejtuar Komisionit. Kjo ka të bëjë me ndërprerjen arbitrare të procedimit për doktoraturë, me mosfillimin e vitit akademik 2005/06 për doktoraturë për këta kandidatë dhe me konkursin publik të 19 janarit 2009 të UP-së për studimet e doktoraturës - shumica e këtyre kandidatëve nuk janë ftuar fare në testim për gjuhën angleze.

Për këtë çështje Komisioni vendosi që me anë të një shkrese të kërkojë sqarime shtesë nga Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

E hartoi stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni